

# TRASHËGIMIA KULTURORE NË

# FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPËRI

TRASHËGIMIA  
KULTURORE NË  
FO  
KU  
S.



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE  
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE  
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

**Titulli:** “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

**Përkthimet nga origjinali:** Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

**Redaktoi:** Boiken Abazi

**Parathënie për botimin nga:** Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

**Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:**

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

**Foto:** © Bjori Thana, Regina Vathi

**Dizajni:** Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

**ISBN: 9789928801081**

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

**Shtëpia Botuese:** “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

DOKUMENTIMI, PREZANTIMI, DHE INTERPRETIMI | KARTË

# KARTA E TURIZMIT KULTUROR NDËRKOMBËTAR

## MENAXHIMI I TURIZMIT NË VENDNDODHJET E RËNDËSISHME TË TRASHËGIMISË

Miratur nga ICOMOS-i në Asamblenë e 12-të në Meksikë,  
tetor 1999.

### ICOMOS

Përkthyer nga: Esmeralda Agolli.

Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni original ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

## HYRJE

### FRYMA E KARTËS

Në kuptimin më të gjerë, trashëgimia natyrore dhe kulturore i përket gjithë njerëzmit. Ne të gjithë kemi të drejtën dhe përgjegjësinë të kuptojmë, vlerësojmë dhe konservojmë vlerat e saj universale.

Trashëgimia është një koncept i gjerë që përfshin mjedisin natyror dhe atë kulturor. Aty përfshihen peizazhe, vende historike, site dhe mjedise të ndërtuara, apo edhe biodiversiteti, koleksione, praktika kulturore që vazhdojnë si dhe ato të kaluarat, dije dhe përvoja të jetuara. Ajo regjistron dhe shpreh proceset e gjata të zhvillimeve historike që formojnë esencën e larmisë së identiteteve kombëtare, rajonale, indigjene dhe vendase, si pjesë përbërëse e jetës moderne. Ajo është një pikë referimi dhe instrument pozitiv për rritje dhe ndryshim. Trashëgimia e veçantë dhe memoria kolektive e çdo lokaliteti apo komuniteti është e pazëvendësueshme dhe përbën një themel të rëndësishëm për zhvillimin në të tashmen, ashtu si dhe në të ardhmen.

Mbrojtja, konservimi, interpretimi dhe prezantimi i trashëgimisë dhe larmisë kulturore të çfarëdo vendi apo rajoni mbetet një sfidë e rëndësishme për njerëzit kudo, në kohën e një globalizmi në rritje. Megjithatë, menaxhimi i kësaj trashëgimie zakonisht është një përgjegjësi e komuniteteve të veçanta ose grupeve që e ruajnë atë brenda një kuadri i cili zbaton standardet e duhura dhe të njohura ndërkombëtare.

Një objektivi kryesor për menaxhimin e trashëgimisë mbetet komunikimi i domethënies dhe nevojës së saj për konservim të komuniteti vendas dhe vizitorët. Në zhvillimin e trashëgimisë dhe kulturës qasja fizike e arsyeshme dhe e mirëmenaxhuar, si dhe qasja intelektuale dhe/ose emocionale është njëkohësisht një e drejtë dhe një privilegj. Kjo sjell përgjegjësinë për të respektuar vlerat e trashëgimisë, përfshirë dhe peizazhet dhe kulturat nga të cilat ajo ka evoluuar si dhe për trajtimin e barabartë të komunitetit aktual lokal, të rojtarëve indigjenë, ose pronarëve të pasurive historike.

### NDËRVEPRIMI DINAMIK MES TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Zhvillimi i turizmit të brendshëm dhe ndërkombëtar vazhdon të mbetet një prej mënyrave kryesore të shkëmbimit kulturor, që ofron një eksperiencë personale jo vetëm ngaqë ka mbijetuar nga e shkuara, por edhe për

të kuptuar jetën dhe shoqërinë bashkëkohore të të tjerëve. Gjithnjë e më shumë kjo po vlerësohet si një forcë pozitive dhe me ndikim për konservimin natyror dhe kulturor. Turizmi mund të zhvillojë karakteristikat ekonomike të trashëgimisë duke i shfrytëzuar ato në drejtim të rritjes së financimeve për nevojat për konservim, për edukimin e komunitetit dhe për të ndikuar në politikat publike. Turizmi mbetet një pjesë esenciale e shumë ekonomive kombëtare dhe rajonale dhe mund të shndërrohet në një faktor të rëndësishëm zhvillimi nëse menaxhohet me sukses.

Turizmi, në vetvete, është kthyer në një fenomen gjithnjë e më kompleks, me dimensione politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, arsimore, biofizike, ekologjike dhe estetike. Gjetja e një ndërveprimi të dobishëm mes pritshmërive dhe aspiratave të vizitorëve me ato të komuniteteve vendase ofron shumë sfida, pasi nuk janë dhe aq në harmoni me njëra-tjetrën, por ofron edhe shumë mundësi. Trashëgimia natyrore dhe kulturore, larmitë dhe kulturat ekzistuese krijojnë tërheqje të mëdha turistike. Turizmi i tepruar dhe i keqmenaxhuar, si dhe zhvillimi i lidhur me turizmin, mund të kërcënojnë natyrën fizike, integritetin dhe karakteristikat domethënëse të trashëgimisë. Konteksti ekologjik, kultura dhe mënyrat e jetesës së komuniteteve pritëse mundet gjithashtu të degradohen së bashku me përvojën e vizitorëve të vendit.

Turizmi do duhej t'i sillte përfitime komuniteteve pritëse, duke u siguruar mjete të rëndësishme për t'i motivuar që të mirëmbajnë trashëgiminë dhe praktikatat e tyre kulturore. Për të patur një industri të qëndrueshme turistike dhe për të shtuar mbrojtjen e burimeve të trashëgimisë edhe për brezat e ardhshëm, është e nevojshme përfshirja dhe bashkëpunimi i përfaqësuesve të komuniteteve vendase dhe/ose indigjene me konservuesit e trashëgimisë, operatorët turistikë, pronarët, politikëbërësit, ata që merren me përgatitjen e planeve kombëtare të zhvillimit dhe menaxherët e siteve.

ICOMOS-i (Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Site) si autor i kësaj Karte, organizata të tjera ndërkombëtare dhe industria e turizmit mbeten të përkushtuara në përballimin e kësaj sfide.

### OBJEKTIVAT E KARTËS

#### OBJEKTIVAT E KARTËS NDËRKOMBËTARE TË TURIZMIT KULTUROR JANË:

- Të lehtësojë dhe inkurajojë grupet e përfshira në konservimin dhe menaxhimin e trashëgimisë për mundësimin e qasjes së komunitetit pritës dhe të

- vizitorëve te domethënia e asaj trashëgimie.
- Të lehtësojë dhe inkurajojë industrinë e turizmit për të promovuar dhe menaxhuar turizmin në mënyra që respektojnë dhe shtojnë vlerën e trashëgimisë së kulturave ekzistuese të komuniteteve pritëse.
- Të lehtësojë dhe inkurajojë dialogun mes interesave të konservimit dhe industrisë së turizmit rreth rëndësisë dhe natyrës së brishtë të vendndodhjeve të trashëgimisë, koleksioneve dhe kulturave ekzistuese, duke përfshirë edhe nevojën për të mundësuar një të ardhme të qëndrueshme për to.
- Të lehtësojë dhe inkurajojë formulimin e detajuar të planeve dhe politikave zhvillimore, qëllimeve të matshme dhe strategjive lidhur me prezantimin dhe interpretimin e vendndodhjeve të trashëgimisë dhe aktiviteteve kulturore në kuadër të ruajtjes dhe konservimit të tyre.

Më tej,

- Kjo Kartë mbështet nismat e gjera të ICOMOS-it, organet e tjera ndërkombëtare dhe industrinë e turizmit në mirëmbajtjen e integritetit të menaxhimit dhe konservimit të trashëgimisë.
- Kjo Kartë inkurajon përfshirjen për bashkimin në realizimin e objektivave të saj të të gjithë atyre që kanë interesa të lidhura me çështjen, qofshin dhe në kundërvënie, si dhe të atyre që kanë përgjegjësi dhe detyrime.
- Kjo Kartë inkurajon formulimin e udhëzuesve të detajuar nga palët e interesit, për të lehtësuar zbatimin e Parimeve në rrethanat e tyre specifike ose kërkesat e organizatave dhe komuniteteve të veçanta.

## **PARIME TË KARTËS SË TURIZMIT KULTOROR**

### **PARIMI 1**

Duke marrë parasysh se turizmi brenda vendit dhe ai ndërkombëtar janë mes mjeteve kryesore të shkëmbimit kulturor, konservimi duhet të sigurojë në mënyrë të përgjegjshme dhe të mirëmenaxhuar mundësinë që anëtarët e komuniteteve pritëse dhe vizitorët të përjetojnë dhe kuptojnë trashëgiminë dhe kulturën e komunitetit përkatës në mënyrë të drejtpërdrejtë.

#### **1.1**

Trashëgimia natyrore dhe kulturore është një burim material dhe shpirtëror që ofron narrativën e një zhvillimi historik. Ajo ka një rol të rëndësishëm në jetën moderne dhe publikut të gjerë duhet t'i mundësohet qasja në

mënyrë fizike, intelektuale dhe/ose emociale. Programet për ruajtjen dhe konservimin e atributiveve fizike, aspekteve jomateriale, shprehive kulturore bashkëkohore dhe konteksti më i gjerë duhet të lehtësojnë të kuptuarin dhe vlerësimin e rëndësisë së trashëgimisë nga komuniteti pritës dhe vizitorët në një mënyrë të drejtë dhe financiarisht të përballueshme.

#### **1.2**

Aspekte individuale të trashëgimisë kulturore dhe natyrore kanë nivele të ndryshme të domethënies: disa kanë vlera universale, të tjera kanë vlera kombëtare, rajonale ose me rëndësi lokale. Programet interpretuese duhet që komunitetit pritës dhe vizitorëve t'i prezantojnë në një mënyrë të përshtatshme dhe të qasshme domethënien e trashëgimisë përmes formave të përshtatshme, stimuluese dhe bashkëkohore të edukimit, medias, teknologjisë dhe shpjegimit personal të informacionit historik, mjedisor dhe kulturor.

#### **1.3**

Interpretimi dhe prezantimi i programeve duhet të lehtësojë dhe inkurajojë ndërgjegjësimin qytetar në nivele të larta dhe mbështetjen e nevojshme për mbijetesën afatgjatë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

#### **1.4**

Programet e interpretimit duhet të prezantojnë rëndësinë e vendndodhjeve (vendeve) të trashëgimisë, traditave dhe praktikave kulturore, duke përfshirë përvojat e së shkuarës dhe larminë aktuale të zonës dhe komunitetit pritës, përfshirë pakicat kulturore dhe gjuhësore. Vizitorët duhet gjithnjë të jenë të informuar lidhur me vlerat e ndryshme kulturore që mund t'i atribuohen një burimi të veçantë të trashëgimisë.

### **PARIMI 2**

Marrëdhënia mes vendndodhjeve (vendeve) të trashëgimisë dhe turizmit është dinamike dhe mund të përfshijë vlera konfliktuale. Kjo marrëdhënie duhet të menaxhohet në një mënyrë të qëndrueshme për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

#### **2.1**

Vendndodhjet (vendet) e rëndësishme të trashëgimisë kanë vlera të qenësishme për të gjithë njerëzit, dhe janë baza të rëndësishme të larmisë kulturore dhe zhvillimit shoqëror. Mbrojtja dhe konservimi afatgjatë i kulturave ekzistuese, vendndodhjeve të trashëgimisë, koleksioneve, integritetit të tyre fizik dhe ekologjik dhe kontekstit të tyre mjedisor, duhet të përbëjnë një aspekt thelbësor shoqëror, politik, legjislativ,

kulturor dhe turistik të politikave zhvillimore.

## **2.2**

Ndërveprimi mes turizmit dhe burimeve, ose vlerave, të trashëgimisë është dinamik dhe gjithnjë në ndryshim, dhe kjo gjë vazhdimisht dhe njëkohësisht krijon mundësi dhe sfida, por edhe konflikte të mundshme. Projektet e turizmit, aktivitetet dhe zhvillimet duhet të sjellin rezultate pozitive dhe të minimizojnë ndikimet negative mbi trashëgiminë apo mënyrat e jetesës së komuniteteve pritëse, ndërkohë që u përgjigjen nevojave dhe aspiratave të vizitorëve.

## **2.3**

Konservimi, interpretimi dhe zhvillimi i programeve të turizmit duhet të bazohet në të kuptuarin tërësor të specifikës, e cila shpesh bart aspekte komplekse dhe konfliktuale të domethënies së trashëgimisë së një vendndodhjeje të caktuar. Puna kërkimore dhe konsultimet e vazhdueshme janë të rëndësishme për të zgjeruar të kuptuarit dhe vlerësimin e domethënies.

## **2.4**

Ruajtja e autenticitetit të vendndodhjeve të trashëgimisë dhe koleksioneve është e rëndësishme. Kjo përbën një element esencial të domethënies së tyre kulturore, të shprehur në elementët fizikë, kujtimet e grumbulluara dhe traditat jomateriale që vijnë nga e kaluara. Programet duhet të prezantojnë dhe interpretojnë autenticitetin e vendndodhjeve dhe përvojave kulturore për të rritur vlerësimin dhe të kuptuarit e trashëgimisë kulturore.

## **2.5**

Zhvillimi i projekteve të infrastrukturës dhe turizmit duhet të marrë në konsideratë dimensionet estetike, kulturore, shoqërore dhe peizazhet natyrore dhe kulturore, karakteristikat e biodiversitetit dhe kontekstin e gjerë pamor të vendndodhjeve të trashëgimisë. Përdorimi i materialeve vendase duket të gëzojë përparësi, dhe duhen marrë parasysh stilet e arkitekturës vendase bashkë me traditat e përditshme.

## **2.6**

Përpara se vendndodhjet e trashëgimisë të promovohen apo zhvillohen për rritjen e turizmit, planet e menaxhimit duhet të shqyrtojnë vlerat natyrore dhe kulturore të një burimi. Më tej ato duhet edhe të përcaktojnë kufizimet e përshtatshme për nivelin e pranueshëm të ndyshimeve, veçanërisht në lidhje me ndikimin e numrit të vizitorëve në karakteristikat fizike, integritetin, ekologjinë dhe biodiversitetin e vendndodhjeve të trashëgimisë. Gjithashtu duhet patur parasysh qasja në burimin e trashëgimisë,

sistemet e transportit dhe mirëqënia shoqërore, ekonomike dhe kulturore e komuniteteve pritëse. Nëse niveli i pritshëm i ndryshimit është i papranueshëm, atëherë propozimet zhvillimore duhet të modifikohen.

## **2.7**

Duhet të ketë programe të vazhdueshme të vlerësimit për të shqyrtuar ndikimin në rritje të aktiviteteve turistike dhe zhvillimit mbi një vendndodhje të posaçme, ose një komunitet.

## **PARIMI 3**

Konservimi dhe planifikimi i turizmit për vendndodhjet (vendet) e trashëgimisë duhet të sigurohet që përvoja e vizitorëve t'ia vlejë, të jetë e kënaqshme dhe gëzimprurëse.

### **3.1**

Konservimi dhe programet e turizmit duhet të ofrojnë informacion të cilësisë së lartë për të shtuar kuptimin nga ana e vizitorëve mbi domethënien e karakteristikave të trashëgimisë dhe nevojën për mbrojtjen e tyre, si dhe duke i mundësuar vizitorëve ta përjetojnë një vend në mënyrën e duhur.

### **3.2**

Vizitorët duhet të jenë në gjendje ta përjetojnë një vendndodhje të trashëgimisë me ritmin e tyre, nëse kjo është zgjedhja e tyre. Itinerare të veçanta të qarkullimit mund të jenë të nevojshme për të minimizuar ndikimin mbi integritetin dhe strukturën fizike të një vendi, si dhe të karakteristikave natyrore dhe kulturore të tij.

### **3.3**

Respekti për shenjtërinë e vendeve shpirtërore, praktikave dhe traditave duhet të konsiderohen të rëndësishme për menaxherët e siteve, politikëbërësit, planifikuesit dhe operatorët turistikë. Vizitorët duhet të inkurajohen që të sillen si mysafirë të mirëpritur që respektojnë vlerat dhe mënyrat e jetesës së komuniteteve pritëse, duke refuzuar vjedhjet e mundshme apo tregtinë e paligjshme të pronave kulturore, si dhe duke u sjell në atë lloj mënyre të përgjegjshme që do të çonte drejt mirëpritjes se tyre sërish në të ardhmen, nëse do të riktheheshin.

### **3.4**

Planifikimi për aktivitetet e turizmit duhet të sigurojë lehtësirat e duhura për rehatinë, sigurinë dhe mirëqënien e vizitorit, duke e shtuar gëzimprurjen gjatë vizitës, por pa krijuar një efekt të kundërt të tipareve domethënëse apo karakteristikat

ekologjike.

#### **PARIMI 4**

Komunitetet pritëse dhe popujt indigjenë duhet të përfshihen në planifikimin për konservim dhe turizëm.

##### **4.1**

Duhet respektuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve pritëse në nivel rajonal dhe vendor, e pronarëve të pronave dhe e popujve përkatës indigjenë që janë mbajtës të drejtash në bazë të traditës, ose që kanë përgjegjësi mbi tokën e tyre dhe sitet e saj domethënëse. Ata duhet të përfshihen në përcaktimin e qëllimeve, strategjive, politikave dhe protokolleve për indentifikimin, konservimin, menaxhimin, prezantimin dhe interpretimin e burimeve të tyre të trashëgimisë – praktikave dhe shprehive bashkëkohore kulturore – në kontekstin turistik.

##### **4.2**

Ndërkohë që trashëgimia e ndonjë vendndodhjeje apo rajoni specifik mund të ketë dimension universal, duhet të respektohen nevojat dhe dëshirat e disa komuniteteve apo popujve indigjenë për të kufizuar ose menaxhuar qasjen fizike, shpirtërore ose intelektuale, në përputhje me disa praktika kulturore, njohuri, besime, aktivitete, artefakte ose site.

#### **PARIMI 5**

Turizmi dhe aktivitetet e konservimit duhet të jenë në dobi të komuniteteve pritëse.

##### **5.1**

Politikëbërësit duhet të promovojnë masa për shpërndarjen e drejtë të përfitimeve nga turizmi, që duhen ndarë mes shteteve apo rajoneve, me synim përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe kontributdhënien në zbutjen e varfërisë aty ku nevojitet.

##### **5.2**

Menaxhimi i konservimit dhe i aktiviteteve turistike duhet të sigurojë një ndarje të drejtë të përfitimeve ekonomike, shoqërore dhe kulturore për burrat dhe gratë e komuniteteve pritëse ose vendase, në të gjitha nivelet, përmes edukimit, trajnimeve dhe krijimit të mundësive të punësimit me kohë të plotë.

##### **5.3**

Një pjesë domethënëse e atyre të ardhurave që krijohen

nga programet e turizmit në vendndodhjet e trashëgimisë duhet të ndahet për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e këtyre vendndodhjeve, përfshirë edhe kontekstin e tyre kulturor dhe natyror. Aty ku është e mundur, vizitorët duhet të vihen në dijeni për ndarjen e të ardhurave.

##### **5.4**

Programet e turizmit duhet të inkurajojnë trajnimin dhe punësimin e udhërrëfyesve dhe interpretuesve të siteve nga komunitetet pritëse, për të rritur aftësimin e individëve vendas në prezantimin dhe interpretimin e vlerave të tyre kulturore.

##### **5.5**

Interpretimi i trashëgimisë dhe programet arsimore të njerëzve në komunitetet pritëse duhet të inkurajojnë përfshirjen e interpretuesve vendas të siteve. Programet duhet të promovojnë dije dhe respekt për trashëgiminë e tyre duke inkurajuar vendasit të interesohen drejtëpërdrejt për përkujdesjen dhe konservimin e trashëgimisë.

##### **5.6**

Programet e menaxhimit të konservimit të trashëgimisë dhe programet e turizmit duhet të përfshijnë mundësi arsimimi dhe trajnimi edhe për politikëbërësit, planifikuesit, projektuesit, kërkuesit shkencorë, arkitektët, interpretuesit, konservuesit dhe operatorët turistikë. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen të kuptojnë dhe ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve, nganjëherë konfliktuale, si dhe në lidhje me mundësitë dhe problemet që hasin kolegët e tyre.

#### **PARIMI 6**

Programet promovuese turistike duhet të mbrojnë dhe të nxjerrin në pah karakteristikat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

##### **6.1**

Programet e promovimit turistik duhet të krijojnë pritshmëri realiste, duke i informuar me përgjegjësi vizitorët potencialë mbi karakteristikat specifike të trashëgimisë së një vendndodhjeje, apo komuniteti pritës, në mënyrë që ata të inkurajohen të sillen siç duhet.

##### **6.2**

Vendndodhjet dhe koleksionet e rëndësishme të trashëgimisë duhet të promovohen dhe menaxhohen duke mbrojtur autenticitetin e tyre, duke përmirësuar

përvojën e vizitorit përmes minimizimit të flukseve në mbërritje dhe shmangies së përqëndrimit të numrit të lartë të vizitorëve në të njëjtën kohë.

### **6.3**

Programet e promovimit të turizmit duhet të sigurojnë shpërndarje më të gjerë të përfitimeve dhe të ulin trysinë mbi vendndodhjet më të popullarizuara, duke i inkurajuar vizitorët të përjetojnë një përvojë më të gjerë të karakteristikave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit apo lokalitetit.

### **6.4**

Promovimi, shpërndarja dhe shitja e produkteve artizanale vendase, apo edhe e produkteve të tjera, duhet të sigurojë një përfitim të arsyeshëm shoqëror dhe ekonomik për komunitetet pritëse, si dhe njëkohësisht duhet të sigurohet që mos të degradohet integriteti i tyre kulturor.